

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL- GJILAN**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr1 i prokurimit	651-22-10313-2-1-1
Nr i brendshëm	GL 651 022 091 211

Sa i përket tenderit për: **Sinjalizimi Horizontal, vertikal dhe paisjeve rrugore ne Komunen e Gjilanit**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

NSh Liriu (Selman Kolgeci B.I)

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr.Brigada 123 Suharekë p.n-Suharekë

(Adresa

Prishtinë

23000

(Vendi)

049-502-555

(Kodi postar)

N/A

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Selman Kolgeci

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

nsh.Liriu@gmail.com

(Adresa elektronike)

09.08.2023



¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

N/A

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë me datë 29.09.2023

Hapja e Ofertave me datë 06.03.2023

Njoftimi i parë mbi vendimin e AK-së me datë 07.04.2023

Njoftimi i dytë mbi vendimin e AK-së me datë 21.07.2023

Kërkesa për Rishqyrtim e dorëzuar te AK-së me datë 26.07.2023

Vendimi i AK lidhur me kërkesën për rishqyrtim i datës 31.07.2023

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Brenda afatit ligjor përkatsisht me datë 26.07.2023 kemi bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK. kunder Njoftimin mbi vendimin e AK-së (058) për aktivitetin e prokurimit duke sqaruar, se ku AK, ka bërë shkelje me rastin e eliminimit të ofertës tonë për aktivitetin e prokurimit dhe njëkohësisht i kemi bërë sqarime të argumentuara se oferta jonë i plotëson të gjitha kriteret e parapara me njoftim për kontratë dhe dosje të tenderit , Autoriteti Kontraktues me datë 31.07.2023 ka nxjerrë Vendim me të cilin refuzohet kërkesa për rishqyrtim e ushtruar nga ana jonë.

Vlenë të theksohet se me datë 07.04.2023 përmes platformes së e-prokurimit e kemi pranuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues , me të cilin jemi njoftuar se **jemi shpallur fitues** sepse i kemi plotësuar të gjitha kriteret e parapara me njoftim për kontratë dhe dosjen e tenderit dhe kemi ofertuar me çmim më të lirë, ndersa me rastin e rivlerësimit për të nxjerrë vendim-rivlerësim të kunderligjshëm AK ju ka dashur mbi tremuj kohë për ta ri-vlerësuar dhe për të nxjerrë vendim me të cilin rendë do të demtohej buxheti i Komunes sepse jemi kaluar pesë (5) oferta dhe u shpall fitues oferta e gjasht (6) për nga çmimi .

Vlenë të theksohet se AK vetëm sipërfaqsisht e ka shqyrtuar kërkesën për rishqyrtim vetëm ka jep përgjigje të përgjithësuara pa dhënë asnjë arsyetim të bazuar në asnjë pretendim tonin i ka përmendur sipërfaqsisht pretendimet tona por asnjërin nuk e ka shqyrtuar duke dhënë ndonjë përgjigje konkrete por vetëm si të përgjithësuara .

Përveq që është e pa ligjshme dhe e pa kuptueshme që të bëhet qdo tentim dhe të shfrytëzohet qdo mundësi sikurse u shfrytëzua nga ana e AK të eliminohet oferta ma e lirë dhe të bëhet e pa,, mundura e mundurë'' vetëm e vetëm që ti ipt kontrata ofertuesit me çmim ma te shtrejtë (nga shtatë ofertat u shpall fitues ofertuesi i renditur si i dyti me çmim ma te lart do te thotë vetëm edhe një ofertë ishte me çmim ma ta lart kurse neve pesë (5) ofertuesit tjerë ishim me çmim më te lirë) , është jashtëzakonisht shqetësuese , se pretendimet tona janë të bazuara e që nuk po ka asnjë hapësirë për të ja jepë kontratën ofertuesit të preferuarë të AK-së kjo është shkelje flagrante e dispozitave të LPP-së , te behet rivlerësimi apo te zgjatet rivlerësimi mbi tre muajë dhe te thuhet me vendim, se nuk ka afat për sa kohë duhet te kryhet rivlerësimi ku kemi edhe interpretim nga KRPP-ja se rivlerësimi sa i perket afatit është i njejt me vlerësimin qe nenkupton se i njejt duhet te kryhet brenda 30 dite e jo te sterzgjatet ma teper se tre muajë , kjo nenkuptohet se AK ju ka dashur kohe tri here ma e madhe se sa është e parapareë me LPP për nxjerrjen e vendimit të kunderligjshëm dhe nuk befasohem me strzgjatjen e afatit por befasohem me guximin për shkelje të tilla ku me kete veprim e kanë dëmtuar në masë substanciale buxhetin e Komunes duke shpallur fitues oferten me çmim 15 here ma te lart se oferta e jonë dhe ofertat tjera , shpallë fitues oferten e parafundit me çmim ma te lart e që nenkupton se buxheti i Komunes mundë te dëmtohet me qindra



mijra euro dhe kontrata te perfundoj brenda 6 deri 7 muajëve e jo sikurse është paraparë per 36 muaj ,dmth me keto çmime jashtzakonisht te larta kontrata do te perfundoj rriti 30 muaj para kohe sepse buxheti prej 340.000.00€ do te hargjohet qysh 6mujarin e parë sepse oferta e shpallur fitues është me çmime shumë te larta ,andaj ketu perveq shkeljeve te ligjit te prokurimit dhe rregullave dytesore per prokurim keto veprime bien ndesh edhe me kodin penal te republikes së Kosoves sepse kemi te bejm me manipulime me prokurim dhe dëmtim ne masë substanciale te buxhetit te Shtetit.

Veprimi i tillë është shkelje e rënd e nenit 108/A të LPP-së, andaj sikur zyrtari kryesor i prokurimit te ishte me përvorjen e duhur do duhet shqyrtuar mundësinë mbajtjes apo jo të Licencës së zyrtarit përgjegjës të prokurimit, mirëpo meqe i njejt sapo është emruarë në pozitën e njejt ne nuk kerkojm një gjë te tillë .

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së

Neni 6 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 10 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 60 i LPP-së

Neni 61 i LPP-së

Neni 40 i RREGULLORES NR 001/2022

Neni 108/A i LPP-së

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar/a,

Me datë 07.04.2023 përmes platformes së e-prokurimit e kemi pranuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues ,me të cilin jemi njoftuar se jemi shpallur fitues sepse i kemi plotsuar te gjitha kriteret e parapara me njoftm per kontratë dhe dosjen e tenderit .

Me datë 21.07.2023 përmes platformes së e-prokurimit e kemi pranuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues ,me të cilin jemi njoftuar se jemi eliminuar nga aktiviteti i prokurimit edhe pse i kemi plotsuar te gjitha kriteret e parapara me NJK dhe DT.

AK në menyrë të kunderligjeshme,me vetdije sepse nuk ka pasur asnjë dilemë se oferta jonë i plotsonë qdo kriter të paraparë me NJK dhe DT. dhe është ofertë ma e lirë,apo nga 7 ofertat e pranuar ka shpallur fitues oferten me çmim mbi 15 here ma e shtrejt se shumicen e



ofertave të pranuarë e që jemi të përgjegjshëm, autoriteti kontraktues ka bërë që do përpjekje me ja jep kontratën OE me me çmim më të lartë nga gjithsej 7 oferta të pranuarë, oferta e shpallur fituese ishte e parafundit me çmim më të lartë apo nga shtatë ofertat vetëm një ishte më e shtrejt se sa oferta e shpallur fituese me këtë veprim të kanë domtuar apo do ta dëmtojnë buxhetin në masë substanciale.

Me datë 26.07.2023 me kërkesën për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi vendimin e AK e keni potencuar se autoritetet kontraktuese janë të obliguara të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrë me ekonomike ashtu sikurse parashihet me nenin 6 të LPP-së dhe e keni potencuar se duhet AK të ketë në konsideratë nenin 1 të LPP duke potencuar se qëllimi i këtij neni është të sigurojë mënyrën me efikasë, me transparente dhe me të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike dhe të respektojë kriteret e parapara me NJK dhe DT.

Se në jemi ofertë e përgjegjshme dhe me çmim më të lirë e ka konstatuar AK me vlerësimin e parë duke na shpallur neve fitues.

AK fillimisht ka nxierr vendim të drejtë kur neve na ka shpallur fitues sepse ishte vendim i bazuar në kriteret e parapara me NJK dhe me DT.

AK pas ka pranuar kërkesën për rishqyrtim të ushtruar nga OE ankues gabimisht e ka aprovuar kërkesën dhe lëndën e ka kthyer në rivlerësim.

AK na ka kërkuar informata për disa çmime që ju kanë dukur jo normalisht të ulëta, dhe ne i kemi dërguar sqarime siq parashihet me paragrafin 2 -2.1 - 2.3- 2.4 të nenit 61 të LPP-së dhe paragrafit 3 të nenit 61 të LPP-së.

Edhe pse ne kemi jepur përgjigje-sqarime në harmoni me paragrafet e nenit 61.

AK në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 61 nuk i ka marrë parasysh shpjegimet tona të dorëzuara dhe padrejtësisht na ka eliminuar edhe pse ne për secilin pozicion kemi dhënë arsyetim ligjor se nuk kemi ofertuar me asnjë çmim jo normalisht të ulët por të njëjtit janë në harmoni me çmimet e tregut, dhe kemi dalë me çmim të poentuar më të lirë.

Provë: në platformën e e-prokurimit i gjeni të bashkangjiturë arsyetimin për secilin pozicion.

Shihë ri-vlerësimin e AK dhe pretendimin kryesor që u marrë për eliminimin e ofertës tonë shihë shkeljet e AK-së me të cilin na ka eliminuar neve :

Citojë AK : AK me datë 26.06.2023 ka kërkuar sqarim për disa çmime abnormalisht të ulëta për ofertën e OE N.SH „Liriu”

Citojë AK : Komisioni për ekzaminim, krahasim dhe rivlerësim të ofertave në përgjigjejen e OE në fjalë nuk ishte i bindur. Rrjedhimisht komisioni profesional për ekzaminim dhe vlerësim të ofertave ka konstatuar se oferta e juajë është e pa përgjegjshme.

(Mbi tre muajt kohë dhe asnjë veprim siq parashihet për ri-vlerësim)

Ekspertit shqyrtues i kërkojmë me vëmendje ta analizojë këto shkelje :

Shkelja flagrante e AK duke konstatuar se nuk u bindë me përgjigjejet e pranuarë nga OE ankues .

Komisioni nuk ka nevojë të bindet por i njëjti duhet të veprojë në rastin konkret komisioni për rivlerësim nuk ka ushtruar asnjë nga kompetencat që ja jep ligji konkretisht neni 59 dhe 61 i LPP-së sepse :



1. Nuk ka marr parasysh sqarimet ,shpjegimet e OE te cilat i ka ofruar për secilin pozicion madje edhe i ka ofruarë mundesin e rritjes së sigurisë së ekzekutimit ne qfardo perqindje .
2. Nuk ka bërë asnjë hulumtim te tregut, perveq që nuk ka dalë ne teren i njejt.
3. Nuk ka bërë asnjë mundë te bejë hulumtim e tregut as nëpërmes internetit .
4. I njejt as që është lodhur fare te bejë krahasim te çmimeve me ndonjë kontratë paraprake edhe pse çmimi ishte me poentim i njejt do duhej te ndermarr ndonje veprim ose ne treg ,ose ne internet,ose te krahasoj me ndonjë kontratë paraprake dhe me keto veprime do te bindej se çmimet tona janë në harmoni me çmimet e tregut , por pa u lodhur fare vetem ka theksuar se nuk është i bindur me sqarimet e ofruara nga OE ankues ,të njejt nuk janë emruarë për ri-vlerësim për të krijuar bindje , por per te bërë vlerësim te bazuarë e qe nenkupton se nuk kanë ndermarr asnjë veprim që ishin te obliguar te ndermarrin siq e theksova ma lart por vetem kan theksuar se nuk janë te bindur ,e me asnje veprim nuk e kanë arsyetuar bindjen e tyre që ishin të obliguarë të ndermerrnin dhe ne fund te nxierrnin konstatim te drejtë e te bazuarë .

Ne jemi te bindur se AK kanë bërë hulumtim te tregut por çmimet e marra ne treg,interent dhe ne kontrata paraprake nuk i kanë prezentuar sepse te njejtat janë në harmoni me çmimet e ofertës tonë dhe me prezentimin –krahasimin e tyre si ne treg si ne internet apo me kontrata paraprake nuk do te mundë te arsyetonin eliminimin dhe per kete qellim nuk i kanë prezentuar fare,te cilat me një vlerësim real do duhet te prezentonin si :

- Procesverbale te cilat komisioni do duhej ti krijonte ne treg te nenshkruara nga komisioni dhe nga bizneset ku do ta benin hulumtimin ,si dhe

- Deshmit nga interneti dhe

-Ndonje kontratë paraprake ,por fare nuk kanë prezentuar qe do ta deshmonin se çmimet janë apo jo ne harmoini me çmimet e tregut,por pa asnjë deshmi vetem kanë theksuar se arsyetimi i OE nuk është bindës per komisionin pa dhenë asnjë argument se qka nuk ishte sqaruar dhe qka nuk e ka bindë per ketë komision që ka berë ri-vivlerësim mbi tre muaj dhe nuk ka ndermarr asnjë veprim që do duhej ta ndermernte .

AK ka berë shkeljeve thelbesore ka berë edhe shkelje procedurale duke i kaluar të gjitha afatet ligjore per Ri-vlerësim sepse afati per rivlerësim është 30 ditë kalendarike ndersa AK siq e kemi potencuar edhe me lart ka bërë mbi tre muaj per ta perfunduar rivlerësimin,eksperti dhe bordi i OSHP janë të vetdijshtëm se vetem një shkelje vetem procedurale apo qfardo tjeter te jetë e bënë vendimin e pa vlefshëm,pa ligjshëm dhe landen e kthen në rivendosje apo ne rastin konkret në ri-vlerësim.

Te pakenaqr me vendimin B58 te dates 21.07.2023, kemi bërë kerkese per rishqyrtim brenda afatit ligjore te parapare ne nenin 108/A te LPP-se, me pretendimin kryesore se nuk i keni respektuar dispozitat e nenit 59 te LPP-se, ku ne pamundesi per te na eliminuar ne aspektin administrativ e keni gjetur formen me te kunderligjshme per ta demtuar buxhetin dhe njeherit duke vepruar ne kundershtrim me parimin baze te Ligjit per Prokurim Publik - Parimi i Ekonomicitetit, sepse keni rekomanduar per kontrate nje oferte me cmim shume te lartë dhe pa dhene ndonje arsye konkrete.

Kemi potencuar dhe prapë theksojm se ky veprim i juaji perben edhe elemente te vepres penale, rast me te cilin do te merremi dhe do ti njoftojme edhe organet tjera kompetente pas perfundimit te disa procedurave sic parashihen ne nenin 108/A te LPP-se.



Siq jeni ne dijeni me daten: 22.07.2023, kemi parashtruar nje kerkese per qasje ne dokumentacion zyrtare, konkretishte lidhur me oferten e rekomanduarit per kontrate, në menyre qe te bejme krahasimin e cmimeve dhe te ju argumentojme se oferta jonë është e ngjaishme edhe me ofertat e tjera sepse çmimet janë shumë te peraferta .

Edhe OE i rekomanduari per kontrate ka cmime te cilat mund te konsiderohen si cmime shume te larta, sepse ne vleresojme se jemi diskriminuar dhe se AK ka vepruar ne kundershtrim me nenin 7 te LPP-se sepse ne nenin 59 te LPP-se, perveq vleresimit te ofertave

ky nen parashih edhe krahasimin e ofertave qe te cilen nuk e keni bere dhe mosveprimi siq ju sqaruam me larte eshte nje nga elementet e vepres penale perveq shkeljes se dispozitave te nenit 59 te LPPse.

Ne ditën e parapare per qasje ne dokumentacion te ofertes se OE te rekomanduar per 4/3 F02 Formulari Standard per rishqyrtim te vendimit ne AK kontrate, AK nuk na keni dhene asnje dokumente perpos certifikates se biznesit dhe kjo bie ne kundershtrim me nenin 10 paragrafin 5 te LPP-se sepse pavarsishte nje kerkese te dorezuar nga nje operatore ekonomik, ju si autoritet kontraktues keni qenë te obliguar te na i jepni sepse asnje kerkese/deshmi e kerkuar ne dosje te tenderit nuk ka te beje me ndonje sekret afarist ku do te cenohej ndonje interes i kompanise.

Pasi qe nuk na është ofruar qasja ne kemi kerkuar qe te na jepni pergjigje per secilen kerkese veq e veq te dosjes se tenderit se a e ploteson secilen kerkese te dosjes se tenderit dhe njeherit kemi kerkuar te na qe te na e bashkangjitni me vendim kerkesen per konfidencialitet te OE te rekomanduar per kontrate.

Pra ne dhamë shume argumente se AK ne kundershtrim me nenin 10 të LPP-së ka berë shkelje duke anashkaluar apo duke mos i respektuar mjetet per promovimin e transparencës.

Fakti se AK ka vepruar ne kundershtrim me nenin 59 dhe nenin 7 te LPP-se dhe nenin 40.3 te Rregullores per Prokurim publik nr. 001/2022, sepse vleresimi i ofertave nga ana e AK-së ka perfunduar per afer 3 muaj, ndersa ne nenin 40.3 te Rregullores afati per vleresim është 30 dite.

Ndersa AK ka vepruar ne kundershtrim me nenin 6 te LPP-se dhe nenin 60 te LPP-se duke rekomanduar per kontrate nje oferte me cmim shumë me te shtrejte dhe duke e demtuar rende buxhetin. Duke u bazuar ne ato qe u than me larte kerkojme qe ankesa te aprovohet si e bazuar dhe mbetet fuqi vendimi B58 i dates: 07.04.2023 ose landa te kthehet ne rivlerësim (vendimi paraprak kur ne jemi shpallur fitues)

Shkelja e nenit 56 të LPP-së , AK nuk mundë të bëjë vlerësim mbi ndonjë kriter që nuk u parapa me NJK dhe DT. kjo bjen ne kundershtrim me nenin 56 të LPP-së perkatsisht parag.3 citoj : Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kerkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.



Tani me shqyrtimin e drejtë të pretendimeve tona nga një Ekspert i prokurimit dhe një vendim i drejtë i OSHP-së që ne shpresojmë dhe kemi besim të plotë në profesionalizmin e Bordit dmth me një vendim të drejtë dhe të bazuarë në dispozitat e LPP-së do të rezultojë me keto të mira:

-Fillimisht do të kursehen buxhetit të Kosovës përkatsisht Komunes së Gjilanit me vlera të jashtzakonshme dhe do ta shpetojë AK që të mos mbetet pa kontratë përafersisht 30 muaj sepse me oferten e rekomanduar me çmime shumë të larta buxheti do të shpenzohet qysh në 6 muajin e parë .

-Në bazë të një vendimi të drejtë dhe të ligjshëm ne do të marrim drejtësinë e neperkembur ,nga AK Komuna e Gjilanit që ka bërë më tepër se tre muaj rivlerësim .

Ekzaminimi ,rivlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së ,sepse u eliminua oferta me çmim më të lirë edhe pse oferta jonë ishte në harmoni me kriteret e paraparta me NJK dhe me DT . dhe ne ishim ofertuesi me çmim më të lirë siq ishte kriteri i paraparë me NJK dhe me DT dhe sikurse parashihet me paragrafin 1.1 të nenit 60 të LPP-së tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët ,gjithashtu me këtë rast kjo u bë në kundërshtim edhe me nenin 61 të LPP-së sepse oferta jonë ishte në harmoni me çmimet e tregut .

Po ashtu me veprimet e kundershtueshme të AK ne jemi diskriminuar në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së sepse AK Komuna e Gjilanit edhe pse oferta jonë ishte ofertë që i plotëson të gjitha kriteret e parapara me NJK dhe me DT. prapë nuk na ka shpallur fitues por ka bërë të gjitha përpjekjet vetëm e vetëm që të gjejë ndonjë arsye me na diskualifiku ka kërkuar informata për disa çmime që kinse janë jo normalisht të ulëta ,edhe pse ka pranuar përgjigjeje për secilin kërkesë të njëjtat nuk i ka vlerësuar por prapëseprap neve na ka eliminuar,kurse tani me vendimin e tillë ne jemi diskriminuar sepse oferta jonë i plotëson të gjitha kriteret e parapara me NJK dhe me DT. dhe jemi ofertuesi më i lirë andaj jemi diskriminuar dhe jo të trajtuar në mënyrë barabartë sikurse parashihet me nenin 7 të LPP-së

Gjithashtu AK në kundërshtim me nenin 6 të LPP-së pa pasur asnjë arsye e ka neglizhuar vendimarrjen e drejtë,sepse ne ishim ofertues që i kemi plotësuar të gjitha kriteret e parapara me NJK dhe me DT dhe ishim me çmim nga 7 ofertuesit oferta e përgjegjshme më e lirë se ofertuesi i shpallur fitues paraprakisht kurse tani jemi eliminuar pa asnjë arsye të ligjshme.

Gjithashtu AK në kundërshtim me nenin 1 të LPP-së ku dihet se qëllimi i këtij neni ndër të tjera është të sigurojë mënyrë me efikasë ,më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike ,duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen ,procedurat që do të ndiqen ,të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik dhe autoritetet kontraktuese .

Ne jemi ofertues që i plotësojmë të gjitha kriteret e parapara me NJK dhe me DT dhe kemi ofertuar me çmim më të lirë se OE i rekomanduar për kontratë ,e tani me Njoftim mbi vendimin e AK me të cilin u njoftuam për eliminim AK kërkon në kundërshtim me qëllimin e nenit 1 të LPP-së ka nxirrë këtë vendim

Andaj AK me këto veprime të kundershtueshme dhe përveç se janë në kundërshtim me dispozitat e cekura më lart të LPP-së edhe me dispozitat e të Kodit Penal të Republikës së Kosovës me nr 06/L-074 KPRK-së ne mendojmë se AK me këto veprime ka rëndësuar me këto nene të Kodit Penal të Kosovës si neni 8 neni 415 KPRK-së e për këto veprime të kundershtueshme shpresojmë që ekspertët dhe bordi i OSHP-së të eliminonë dhe mos të detyrohen të hapin rast në organet kompetente .



Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe deshmیتë që u ceken më lartë ,kerkojm që Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik të nxirr:

VENDIM

APROVOHET ANKESA e OE „N.SH. LIRIU “ si e bazuar .

ANULOHET Njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për aktivitetit e prokurimit dhe lenda të kthehet në **Rivlerësim** dhe rivlerësimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e Njoftimin per Kontrat dhe Dosjes së Tenderit duke pasur parasysh dispozitat e LPP-së apo t'i jepni **Urdhër autoritetit kontraktues** duke e detyruar autoritetin e tillë që të korrigjojë shkeljet e pretenduara.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona ,ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore me institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Deri më tani dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës,për pregaditjen kërkesës për rishqyrtim dhe ankesës,na janë bërë në vlerë prej 1,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përfputhje me nenin 108A te LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përfputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

